



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 15-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 25.07.2023, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 09,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Idajet Garip, anëtar
7. Zoran Cirkovic, anëtar
8. Sllavisa Trajkovic

Të tjerë prezent

1. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
2. Përfaqësues të OSBE-së,
3. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Vizitë në vendbanimin ku jetojnë komuniteti ashkali në Medvec

Pastaj kryesuesi i komitetit Skënder Bikliqi, tha se po e vazhdojmë vizitën në teren ashtu siç e kemi parapare me rend të ditës.

Me të arritur në teren me Medvec kryesuesi i komitetit Skënder Bikliqi, tha se po ia kaloj fjalën nënkryetarit të komunës Lulëzim Qerimit të na njoftoj për gjendjen e komitetit në këtë fshat.

Lulëzim Qermimi nënkryetar i komunës tha se në fshatin Medvec janë bërë disa investime dhe po vazhdojnë të bëhen dhe investime tjera siç janë rregullimi i kroit të fshatit rregullimi i lumit, disa rrugica në fshat dhe disa projekte tjera investim nga komuna dhe donator të ndryshëm. Po ashtu tha se këtu ka raporte shumë të mira në mes të komuniteteve.

Pastaj nga anëtarët e komitetit u bënë disa pyetje lidhur me çështjen e ujit të pijes pastaj për braktisjen e mësimin nga nxënësit e komunitetit, rregullimi i trotuarit si dhe disa kërkesa tjera.

Nënkryetari i komunës Lulëzim Qerimi, tha se tani gjendja me ujë të pijshëm është me e mirë dhe nuk ka probleme, po edhe braktisja e mësimin nga nxënësit e komunitetit është duke u përmirësuar dhe nuk kemi me braktisje pasi që ne si komunitet kemi kërkuar nga DKA-ja, që ata nxënësit të cilët e braktisin mësimin prindërit e tyre të ndëshkohen.

Me që diskutime tjera nuk pati, kryesuesi i komitetit Skender Bikliqi, tha se po e vazhdojmë vizitën pak edhe në Magurë, po e shohim edhe aty gjendjen e komuniteteve. Pastaj u vizituan disa familje në fshatin Magurë dhe u diskutua nga disa banorë me investimet të cilat janë bërë në këtë fshat por edhe me disa sfida me të cilat po përballen këta banorë.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12³⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi